

# Newsletter

## Autoriteti i Konkurrencës gjatë muajve Tetor-Dhjetor 2024 ka marrë 35 vendime:

- **Marrëveshje e ndaluar:** 6 vendime;
- **Abuzim me pozitën dominuese:** 5 vendime;
- **Përqendrime:** 16 vendime;
- **Vendime me gjobë:** 2 vendime;
- **Rekomandime:** 2 vendime;
- **Vendime të tjera:** 4 vendime.



### Ndër vendimet më të rëndësishme mund të përmendim:

#### 1 Hapja e procedurës së hetimit paraprak

Autoriteti i Konkurrencës vendos nën hetim paraprak Bankat e nivelit të dytë për abuzim me pozitën dominuese për produktin “sigurimi i jetës për kredi”.

Autoriteti i Konkurrencës, pas marrjes së një ankese hapi procedurën e monitorimit në tregun e sigurimit të jetës për kredi. Më tej, Komisioni i Konkurrencës pasi vlerësoi ekzistencën e të dhënave të mjaftueshme të cilat kërkojnë hetim të mëtejshëm të mënyrës sesi bankat e nivelit të dytë procedojnë me ndarjen e këtij produkti, shqyrtoi në mbledhjen e datës 07.11.2024 propozimin e sekretariatit të konkurrencës për hapjen e hetimit paraprak në këtë treg.

Pas vlerësimit të raportit të paraqitur nga sekretariati i konkurrencës u vlerësua se përqindja e ndarjes së tregut të sigurimit të jetës për kredi, nuk reflekton as afërsisht pjesën e tregut në total që secila nga shoqëritë e sigurimit të jetës zotëron, ç’ka mund të jetë pasojë e sjelljeve përjashtuese me karakter antikonkurrues duke bërë që klientët (kredi marrësit) mos të jenë të lirë të zgjedhin sigurimin e jetës për kredi nga shoqëri sigurimi të përzgjedhura nga vetë ata.

Sjellja e bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi mund të sjellë kufizim të konkurrencës në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, **me vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024**, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi.

Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore nga 7 Nëntor 2021 deri në 7 Nëntor 2024.

## 2 Mbyllje e procedurës së hetimit të thelluar

Autoriteti i Konkurrencës mbylli procedurën e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit (djathë dhe gjalpë)”. 

Në datën 07.11.2024 Autoriteti i Konkurrencës, mbylli procedurën e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit (djathë dhe gjalpë)”.

Në përfundim të hetimit të thelluar, pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurës hetimore si dhe analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të produkteve djathë i bardhë lope, djathë i bardhë dele, djathë i bardhë dhie, djathë kaçkavall lope, djathë kaçkavall dele dhe gjalpë lope, për sa i përket analizës së konkurrencës: strukturës së tregut, çmimeve të shitjes me shumicë dhe fuqisë ekonomike financiare, rezulton se nuk janë gjetur evidenca direkte dhe indirekte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve, duke mos vërejtur shenja të një marrëveshje ose sjellje të bashkërenduar midis tyre, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Gjithashtu, duke marrë parasysh kriteret e vlerësimit të pozitës dominuese, si: pjesën e tregut të ndërmarrjeve, barrierat për hyrjen në treg, konkurrencën potenciale, fuqinë kundërvepruese të blerësve, fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, rezulton se nuk ka ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun përkatës, për rrjedhojë nuk jemi në kushtet e zbatimit të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003. Pavarësisht sa më sipër, problematikat e ndeshura gjatë hetimit kërkojnë marrjen e disa masave nga institucionet përkatëse. Për këtë arsye, Komisioni i Konkurrencës **me vendimin nr. 1131, datë 07.11.2024**, në vijim të mbylljes së hetimit, vendosi edhe:

1. T’i rekomandojë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit:

- Të përforcojë rolin e tij për zbatimin me rigorozytet të kontrolleve përsa i përket cilësisë dhe parametrave mikrobiologjikë të qumështit si lëndë e parë.

2. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave:

- Të ndërmarrë nisma për një “Strategji të integruar në luftën kundër informalitetit” si institucioni kompetent dhe përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e informalitetit në treg.

3. T’i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që:

- Të ndërmarrë nismën për hartimin dhe rishikimin e akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 9441, datë 11.11.2005, me qëllim rregullimin e tyre dhe rritjen e konkurrencës në treg, bazuar në problematikat e konstatuara në tregun e prodhimit dhe tregtimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij;
- Të ndërmarrë nismën për krijimin e një baze të dhënash për monitorimin e çmimeve me pakicë të produkteve të shportës (nënprodukteve të qumështit), me qëllim rritjen e konkurrencës përmes transparencës dhe krahasueshmërisë më të mirë të këtyre çmimeve online.

3

## Hapja e procedurës së hetimit të thelluar

Autoriteti i Konkurrencës hap procedurën e hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij, datë 04.10.2024, vlerësoi të dhënat e marra gjatë fazës së hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

Pas analizimit të strukturës së tregut, integritimit vertikal, sjelljes së ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri tek konsumatori fundor, u vlerësua se ky treg mund të ketë sjellje antikonkurruese. si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, **me vendimin nr. 1114, datë 04.10.2024** vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar, hetim i cili do të përfshijë periudhën kohore 1 Janar 2023 – 30 Shtator 2024.



## Aktivitete



Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Malit të Zi.

Ditën e sotme, datë 07.10.2024 Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës z. Denar Biba priti në një vizitë pune, Kryetarin e Autoritetit të Konkurrencës të Malit të Zi z. Dragan Damjanovic.

Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i bashkëpunimit midis dy institucioneve, në kuadër të rritjes së konkurrencës në treg dhe integritimit ekonomik nëpërmjet një ekonomie tregu të hapur dhe sa më konkurruese!

Në këtë kontekst, u nënshkrua dhe Marrëveshja e Mirëkuptimit në Fushën e Zbatimit dhe Politikës së Konkurrencës.

Kjo marrëveshje, synon të rrisë edhe më tej shkëmbimin e informacionit dhe politikat në fushën e zbatimit të ligjit të konkurrencës, ndarjen e ekspertizës në fushën e hetimeve lidhur me shkeljen e rregullave të konkurrencës, shkëmbimin e përvojave në fushën e promovimit të konkurrencës si dhe organizimi i vizitave studimore dhe trainimeve të ekspertëve.

Autoriteti i Konkurrencës vijon të ketë si një nga synimet e tij parësore, zgjerimin e bashkëpunimit me Autoritetet e Konkurrencës së vendeve të rajonit dhe më gjerë, me qëllim promovimin dhe rritjen e kulturës së konkurrencës.





## Aktivitete



Autoriteti i Konkurrencës, organizoi në 17 Tetor 2024, në ambientet e Hotel Tirana International një workshop me temë “Advokacia e Konkurrencës”, ku u ftuan dhe moren pjese përfaqësues të ndryshëm të mediave.

Aktiviteti u moderua nga Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, z. Denar Biba, dhe anëtarë të stafit të AK-së dhe kishte si synim theksimin e rolit të medias si një urë lidhëse midis Autoritetit të Konkurrencës dhe qytetarëve. Ndërveprimi i vazhdueshëm me median është thelbësor për t'i sjellë publikut një kuptim më të mirë të rolit dhe veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës në mbrojtjen e një tregu të drejtë dhe konkurrues.

Gjatë prezantimeve, u trajtuan çështje të ndryshme të fushës së konkurrencës dhe rëndësia e promovimit të saj për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Workshop-i kontribuon ndjeshëm në ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e konkurrencës së drejte.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Konkurrencës (5 dhjetor 2024) dhe në vijim të aktiviteteve që Autoriteti i Konkurrencës zhvillon për promovimin e kulturës së konkurrencës u zhvillua një workshop me studentët e Fakultetit të Ekonomise, Universiteti i Tiranës.

Në këtë aktivitet u trajtuan çështje të ndryshme të fushës së konkurrencës dhe rëndësia e promovimit të saj për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Studentët dhe pedagogët pjesëmarrës patën mundësinë të dëgjojnë më shumë rreth proceseve të monitorimit dhe zbatimit të ligjit të konkurrencës.

Aktiviteti, i cili u përshëndet edhe nga ana e Dekanit të Fakultetit Ekonomik, z. Bernard Dosti, ngjalli shumë interes tek studentët, ç'ka ndihmon në krijimin e një sinergjie shumë pozitive ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës si institucion i pavarur dhe botës akademike.

